

## SHPALLJE VENDESH VAKANTE PER VITIN 2023

Në zbatim të Ligjit Nr. 10109, datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë” dhe të VKM-së nr. 56, datë 01.02.2023, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023 në njësitë e qeverisjes qendrore”; Drejtoria e Pergjithshme Detare;

- **Shpall 9 (nente) vende vakant për pozicionin “Specialist Kapitenerie”, me kontratë të përkohshme (Prill-Shtator)**, në mbështetje të VKM-së nr56, datë 01.02.2023, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023 në njësitë e qeverisjes qendrore”; (Prill-Shtator)
- **Shpall 1 (një) vend vakant për pozicionin “Specialist per Sigurine Detare”, me kontratë të përkohshme**, në mbështetje të VKM-së nr56, datë 01.02.2023, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023 në njësitë e qeverisjes qendrore” (Prill-Shtator)
  - **Shpall 1 (një) vend vakant për pozicionin “Specialist ne Sektorin e Regjistrimit te Mjeteve Lundruese dhe Detareve”, me kontratë të përkohshme**, në mbështetje të VKM-së nr56, datë 01.02.2023, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023 në njësitë e qeverisjes qendrore” (Prill-Shtator)

### KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT PËR “SPECIALIST KAPITENERIE”, ME KONTRATË TË PËRKOHSHME:

**Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Navigacion/ Inxhinjeri Navale.
- Preferohen të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.
- Preferohen te kene trajnime ne fushen e detarise

### KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT PËR “SPECIALIST PER SIGURINE DETARE” ME KONTRATË TË PËRKOHSHME”:

**Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Navigacion.
- Preferohen te kenë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.
- Preferohen te kene trajnime ne fushen e detarise

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT PËR “SPECIALIST NE SEKTORIN E REGJISTRIMIT TE MJETEVE LUNDRUESE DHE DETAREVE” ME KONTRATË TË PËRKOHSHME”**

**Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, Teknologji Informacioni / Histori
- Preferohen të kenë experience pune ne fushen e arshives, digitalizimit.
- Preferohen te kene trajnime ne fushen arshives dhe teknologjise informacioni.

Marrëdhënia e punës me Drejtorine e Pergjithshme Detare per keto pozicione rregullohet nga dispozitat e ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe në mbështetje të VKM-së nr. 35, datë 19.01.2022“Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore”.

Kandidati duhet të ketë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup.

Kategoria e pagës për pozicionin e “Specialist Kapitenerie”, “Specialist per Sigurine Detare” dhe “Specialist ne Sektorin e Regjistrimit te Mjeteve Lundruese dhe Detareve”, është “Kategoria IV-b”

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune). Diplomat qe janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal ose Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
4. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Dokumentacioni i kerkuar duhet të dorëzohet brenda datës 25 Mars 2023 pranë institucionit të Drejtorise se Pergjithshme Detare në adresën: Rruga Tregtare, Lagja nr.1, Durrës, Zyra e Protokollit ose online ne email: [info@dpdetare.gov.al](mailto:info@dpdetare.gov.al).**